



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:257159
Datë: 29.01.2025
Numri i dokumentit: 06770641

Rev.nr.458/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Lumni Sallauka, kryetar, Muhamet Rexha dhe Beshir Islami, anëtar, në çështjen juridike të paditëses N. H. nga Gj., të cilën e përfaqëson me autorizim Ilir Rashiti avokat nga Gjilani Rr. „Bulevardi i Pavarësisë”, nr. 24, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve „S.” sh.p.k, me seli në P., Rr. „J.”, nr. ..., të cilën e përfaqëson me autorizim Violeta Jashari, avokate nga Prishtina, me objekt kontesti kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 28,440.00€, duke vendosur sipas revizionit të paditurës, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1488/2021, të datës 24.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet pjesërisht i themeltë revizioni i të paditurës Kompania e Sigurimeve „S”. sh.p.k, me seli në P., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1488/2021, i datës 24.04.2024, në pikën I të dispozitivit, si dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti C.nr.231/2018, datë 21.01.2021, në pikën I, shkronja a) dhe b) e dispozitivit, lidhur me kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës, ku tani gjykohet si në vijim: Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve „S.” sh.p.k, me seli në P., që paditëses N. H. nga Gj., në emër të dhimbjeve fizike, t’ia paguaj shumën prej 4.500,00 €, si dhe në emër të frikës, t’ia paguaj shumën prej 3.500,00 €, me kamatë ligjore prej 8%, e cila llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë e deri në pagesën definitive.

II. Refuzohet pjesërisht i pathemeltë revizioni i të paditurës Kompania e Sigurimeve „S.” sh.p.k, me seli në P., në pjesën tjetër të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1488/2021, të datës 24.04.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti C.nr.231/2018, të datës 21.01.2021, është “Aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N. H. nga Gj., e ushtruar ndaj të paditurës Kompania e Sigurimeve „S.” sh.p.k, me seli në P., dhe detyrohet e paditura që

paditëses t'ia kompensoj dëmin material dhe jo material të pësuar nga aksidenti i shkaktuar në komunikacionin rrugor me datë 07.10.2017, në fshatin M., Komuna e K., dhe atë: I. Dëmin jomaterial, me sa vijon: a). Në emër të dhimbjeve fizike të gjitha intensiteteve, shumën e të hollave në lartësi prej 5,500.00€ / pesëmijë e pesëqindën euro/. b). Në emër të frikës të gjitha intensiteteve, shumën e të hollave në lartësi prej 4,500.00€/ katërmijë e pesqindë euro/. c). Në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën e të hollave në lartësi prej 4,500.00 /katërmijë e pesqindë euro/. d). Në emër të shëmtimit estetik, shumën e të hollave në lartësi prej 1,200.00/ njëmijë e dyqindë euro/. Dëmin jo material, të gjitha këto në afat prej 15 dite, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 21.01.2021/si datë e marrjes së aktgjykimit/ e deri në pagesën e fundit. II. Refuzohen si të pabazuara me ligj pjesa tjetër e kërkesave së paditëses N. H. nga Gj. në lartësi prej 1,350.00€ e kërkuar në emër të dhimbjeve fizike, kërkesa në lartësi prej 2,350.00€, e kërkuar në emër të frikës, pastaj kërkesa prej 3,000.00€ e kërkuar në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, si dhe kërkesa prej 600€, e kërkuar në emër të shëmtimit estetik. III. Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve „S.,, me seli në P. që paditëses t'ia kompensoj dëmin material, edhe atë: a). Në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese për tre muaj deri sa paditësja të ketë arritur moshën 65 vjeçare, shumën e të hollave në lartësi prej 900€/ nëntëqindë euro/. b). Në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 400€/ katërqindë euro/. c). Në emër të shpenzimeve të shërimit për terapi fizikale, shumën prej 190€/ njëqind e nëntëdhjetë euro/ si dhe në emër të shpenzimeve tjera të shërimit shumën prej 325€. d). Në emër të kujdesit të personit të tretë shumën prej 850€. IV. Pjesa tjetër e kërkesave të paditëses të kërkuara në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese në lartësi prej 300€, kërkesa në lartësi prej 440€ e kërkuar në emër të ushqimit të përforcuar, kërkesa në lartësi prej 360€ në emër të terapisë fizikale dhe shpenzimeve të shërimit në lartësi prej 1675€, refuzohen si të pabazuara me ligj. E paditura është e detyruar që dëmin material ta kompensoj në afat prej 15 dite, pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data 13.03.2018/ si datë e ushtrimit të kërkesës tek e paditura/ e deri në pagesën e fundit. V. Nga shumat e gjykuara si më lartë, në emër të dëmit material dhe jo material duhet të zvogëlohet detyrimi për 1,500.00€/ njëmijë e pesqindë euro/ i paguar nga e paditura në emër të paradhënies. VI. Detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,168.00€, në afat prej 15 dite pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat ligjore të përmbarimit të dhunshëm”.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, me aktgjykimin Ac.nr.1488/2021, të datës 24.04.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të refuzoj pjesërisht të pathemeltë ankesën e të paditurës Kompania e Sigurimeve „S.” sh.p.k, me seli në P., pika e I-rë, pika e III-të dhe e VI-të e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan–Dega Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.231/2018, të datës 21.01.2021, vërtetohet. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që pika II dhe IV, V, e dispozitivit të aktgjykimit të lartë përmendur mbetet e pa shqyrtuar.

Kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së dytë, brenda afatit ligjor, revizion ka paraqitur e paditura, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj revizionin dhe aktgjykimin e atakuar ta prish dhe çështjen ta kthej në rivendosje.

Paditësja nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të paditurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215, gjeti se:

Revizioni i të paditurës është pjesërisht i themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja më datë 20.06.2018, përmes të autorizuarit të saj, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material, më konkretisht me arsye sikurse në padi, ndërsa më datë 17.12.2020, e ka bërë precizimin e kërkesëpadsisë, ku ka kërkuar nga e paditura që ti kompensohen në emër të dëmit material dhe jo material shumat e cekura si në precizim të kërkesëpadsisë, përfshirë këtu edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padsisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, C.nr.231/18, të datës 21.01.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestuese baza e kërkesëpadsisë, ndërsa në fakt në mes të palëve nuk janë kontestuese faktet se me datën 07.10.2017, në fshatin Mogillë, Komuna e Klllokotit, ka ndodhur aksident i rëndë komunikacioni, për shkak të pakujdesisë së ngasësit të automjetit të markës „Citroen“, tipi Berling, me targa të regjistrimit 0..., të cilën e ngiste A. R. nga V., i cili automjet ishte i siguruar tek e paditura sipas policës së sigurimit me nr. 0..., me ç'rast lëndime të rënda trupore pëson paditësja në cilësinë e këmbësore që në momentin e aksidentit ishte duke lëvizur në trotuar. Fakte të tilla konfirmohen nga Raporti policor me shifrën 2017-CR-578, aktgjykimi penal P.nr. 534/2017, i datës 02.11.2018, me të cilin vendim për aksidentin e shkaktuar është shpallur fajtor dhe është dënuar A. R. nga V. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se e paditura në emër të akontacionit apo paradhënies i ka paguar paditëses shumën prej 1,500.00€. Kontestuese në mes të palëve është vetëm lartësia e kërkesave të paditëses e veçanërisht kërkesa për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm punues, ngase paditësja në kohën e aksidentit ka pasur moshën 64 vjet e 9 muaj dhe se pas mbushjes së moshës 65 vjeçare asaj nuk i takon kjo kërkesë, ngase hynë në skemën e pensionit të pleqërisë.

Lartësinë e kërkesëpadsisë gjykata e shkallës së parë e ka konstatuar nga ekspertizat e komunikacionit dhe ekspertëve mjeko-ligjor nga lëmi i ortopedisë, traumatolog dhe psikiatrisë e hartuar nga ekspertizë të komunikacionit rrugor, nga ana e ekspertit komunikacionit, eksperti i psikiatrisë Dr. Sh. K., ekspertit Dr. Rr. H.- ortoped, traumatolog, si dhe ekspertës nga lëmia e mjekësisë së punës Dr. Q. R.. Ekspertët e lartcekur kanë ardhur në përfundim në bazë të dokumentacionit mjekësor, raportit të emergjencës, raporteve specialistike dhe ekzaminimit të paditësve se paditësit si pasojë e aksidentit ka pësuar lëndime të rënda trupore, këto ekspertiza gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar si profesionale, më të dhëna të mjaftueshëm dhe të besueshme për të caktuar lartësinë e kërkesëpadsisë, andaj të njëjtës i ka dhënë besimin. Më tej gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se për të vërtetuar bazën juridike të padsisë në faktin se e paditura është përgjegjëse për dëmin të cilës paditëses i kanë shkaktuar gjatë aksidentit të komunikacionit, gjykata e detyroj të paditurën që paditësve të ja paguan në emër të dëmit material dhe jo material shumat si në pikën I dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Me rastin e përcaktimit të lartësisë së dëmit gjykata pati në konsiderim të gjitha rrethanat që ndikojnë në përcaktimin e tij, andaj, në bazë të këtyre

pasojave sipas ekspertit paditësja ka pasur dhimbje fizike të intensiteteve të ndryshme që kanë zgjatur dhe zgjasin për periudha të caktuara kohore, i ka gjykuar kërkesat tjera të paditëses lidhur me dëmin material edhe atë: në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese për tre muaj deri sa paditësja të ketë arritur moshën 65 vjeçare, shumën e të hollave në lartësi prej 900€/ nënqindë euro/, duke u bazuar në faktin se paditësja në momentin e aksidentit kishte moshën 64 vjet e 9 muaj, pra në tre muajt vijues ajo mbush moshën 65 vjeçare, kështu që paditëses gjykata ia ka aprovuar kërkesën vetëm për tre muaj në lartësi prej 900€, duke marruar parasysh profesionin e saj si amvise dhe pagën mesatare në Kosovë në bazë të kualifikimit të saj përkatës, gjithnjë duke u mbështetur në mendimin dhe konstatimin e ekspertës nga lëmia e mjekësisë së punës Dr. Q. R., të përpiluar me shkrim të datës 02.03.2020, ku pas analizimit të gjithë dokumentacionit mjekësor ekspertja ka konstatuar se paditësja ka zvogëlim të aktivitetit punues për 16.75% dhe se në të ardhmen nuk do të mund ti kryej punët e amvisërisë, për shkak të pasojave nga aksidenti. Pjesën tjetër të kërkesave të paditëses të kërkuara në emër të zvogëlimit të aftësisë punuese në lartësi prej 300€, kërkesa në lartësi prej 440€ e kërkuar në emër të ushqimit të përforcuar, kërkesa në lartësi prej 360€ në emër të terapisë fizikale dhe shpenzimeve të shërimit në lartësi prej 1675€, janë refuzuar si të pabazuara me ligj, ngase nuk ka pasur prova materiale për këto shpenzime mjekësore. Duke vlerësuar se janë përmbushur kërkesat ligjore nga nenet 200 të LMD-së, si dhe nenit 323 të LPK-së e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses. Vendimi për shpenzimet është marr në bazë të nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit të Kosovës në procedurën e vendosjes sipas ankesës së palës së paditur, me aktgjykimin Ac.nr.1488/2021, të datës 24.04.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të refuzoj pjesërisht të pathemeltë ankesën e të paditurës Kompania e Sigurimeve „S.” sh.p.k, me seli në P., pika e I-rë, pika e III-të dhe e VI-të e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan–Dega Viti, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.231/2018, të datës 21.01.2021, vërtetohet. Në pikën II të dispozitivit ka vendosur që pika II dhe IV, V, e dispozitivit të aktgjykimit të lartë përmendur mbetet e pa shqyrtuar.

Gjykata e Apelit në pjesën arsyetuese ka theksuar se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përfshirë në shkelje esenciale të ligjit të procedurës kontestimore, në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, si dhe e drejta materiale është aplikuar drejtë. Më tej në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar se i kanë rezultuar si të pa bazuara pretendimet ankimore të paditurës për konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes janë provuar me prova përkatëse të cilat janë administruar në një proces të rregullt gjyqësor. Baza juridike e kërkesëpadisë nuk ka qenë kontestuese, por vetëm natyrën e lëndimeve dhe pasojat e saj. Gjendjen faktike për dëmin jo material gjykata e shkallës së parë e ka provuar përmes mendimit të ekspertit mjeko-ligjor, ortopedëve, traumatologëve dhe psikiatërve për të gjitha elementet e dëmit jo-material duke u bazuar edhe në vlerësim të lirë sepse nga ana e gjykatës së shkallës së parë, mendimet e ekspertëve mjeko-ligjor i ka vlerësuar si profesionale, gjithëpërfshirëse dhe reale, duke pas parasysh natyrën e lëndimit, kohëzgjatjen e dhimbjeve si dhe frikës faktin se paditësja në cilësi të këmbësore që në momentin e aksidentit ishte duke lëvizur në trotuar, se kompensimi i dëmit jo-material dhe material në të holla ka për qëllim satisfaksionin për të dëmtuarin dhe jo që të arrihet ndonjë qëllim tjetër shoqëror i këtij kompensimi. Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë shpjegimet e duhura në arsyetim të aktgjykimit, për shumat e gjykuara sipas kategorive të dëmit si përfundim e ka marrë për bazë mendimin e ekspertëve mjekësor, prandaj në këtë kontekst edhe Gjykata e Apelit i ka pranuar vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve, dhe rrethanat tjera

që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, rrethanat tjera moshë e paditësve, dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumtë e gjykuara janë në përputhje me qëllimin shoqëror për kompensimin e dëmit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që kanë pësuar paditësja, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësen, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Gjykata Supreme ka trajtuar revizionin në raport me pretendimet e ngritura për zbatim të gabuar të drejtës materiale dhe në raport me kërkesat për kompensim të gjykuara nga gjykatat e shkallës së parë, të vërtetuara më pas nga gjykata e shkallës së dytë, e të kontestuara me revizion, ndërsa në raport me shkeljet procedurale ka trajtuar vetëm shkeljet për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare (neni 215 të LPK-së), ngase për këtë bazë përkundër faktit që e paditura e ka potencuar si shkelje në revizion, e njëjta për këtë pjesë është thirrur vetëm në shkeljet e LPK-së që kanë të bëjnë me vendimin për shpenzimet e procedurës, duke mos specifikuar ndonjë shkelje tjetër të dispozitave të LPK-së.

Si rezultat i kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, duke vlerësuar se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në përputhje me gjendjen faktike të provuar, duke e detyruar të paditurën që paditëses t'i kompensoj shumtë e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të shkallës së parë, e të vërtetuara nga gjykata e shkallës së dytë. Mirëpo, kjo gjykatë nuk ka pranuar qëndrimin e instancave më të ulëta sa i përket shumave të gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për dhimbje dhe frikën e përjetuar nga paditësja, si rezultat i së cilës për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale edhe në këtë pikë janë ndryshuar aktgjykimet e instancave më të ulëta.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë, pasi ka vlerësuar se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, në përputhje me gjendjen faktike të provuar, duke lënë në fuqi pikën I, III dhe IV të dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, përveç pjesës së ndryshuar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me të cilat është detyruar e paditura që paditëses t'ia kompensoj shumtë e gjykuara sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Sa i përket bazës juridike, përkatësisht përgjegjësisë së të paditurës në bazë të auto përgjegjësisë, të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë e që është pranuar edhe nga gjykata e shkallës së dytë, Gjykata Supreme pranon qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta dhe arsyet që janë dhënë sa i përket detyrimit të paditurës për kompensimin e dëmit paditëses. Shtu këtu edhe faktin se nga shkresat e lëndës rezulton se pala e paditur nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, por vetëm lartësinë e saj.

Gjykata Supreme ka refuzuar pjesërisht revizionin e palës së paditur dhe kërkesën e saj për prishjen e aktgjykimit të shkallës së dytë dhe të parë dhe kthimin e lëndës kësaj të fundit për rivendosje, ku në revizion ka pasur pretendim se shumtë e gjykuara janë shumë të larta. Kjo për faktin se ka rezultuar se të njëjtat pretendime janë të pa bazuara, pasi aplikimi i dispozitave materialo-juridike, të cilave iu është referuar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, përkatësisht dispozitat e nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) është në përputhje me gjendjen faktike, përveç pjesës së ndryshuar, duke marrë në konsideratë konstatimet profesionale të ekspertëve mjekësor mbi natyrën e lëndimeve, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallë prej 15 % dhe të shëmtimit në shkallë të ulët, si dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, siç janë moshë e paditëses dhe praktika gjyqësore për raste

të tilla. Si rezultat i kësaj, kjo gjykatë vlerëson se shumata e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, e të vërtetuara nga gjykata e shkallës së dytë në emër të dëmit jo material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shëmtimin trupor, janë shumata që i përgjigjen qëllimit të kompensimit të dëmit në rastin konkret. Nga arsyet që janë dhënë në lidhje me shumata e gjykuara në emër të kompensimit të dëmit jo material, rezulton se gjykatat e instancës më të ulët me të drejtë e kanë pasur në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi t'i përputhet qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin.

Përveç kësaj, është vlerësim i Gjykatës Supreme se gjykatat e instancës më të ulët kanë vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësja, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësen, dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla. Në këtë kuptim nuk janë pranuar pretendimet e revizionit të paditurës, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykatat e instancës më të ulët kanë vendosur në përputhje me gjendjen faktike dhe se shumata e gjykuara i përgjigjen natyrës së lëndimit dhe pasojave që ka pasur paditësja si rezultat e lëndimit në aksidentin e ndodhur me datë 07.10.2017, si dhe janë në përputhje me dispozitat materiale, përkatësisht nenin 183 të LMD-së.

Në anën tjetër, vlerësohen të pabazuara pretendimet e revizionit të paditurës lidhur me bazën juridike dhe lartësinë e gjykuar për paditësen në emër të dëmit material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm punues, ushqimit të përforcuar, shërimit për terapi fizikale dhe shpenzimeve tjera të shërimit. Në lidhje me këtë, rezulton se gjykatat e instancave më të ulëta drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale me rastin e vendosjes së këtyre kategorive të dëmit material, pasi që është provuar fakti nga ekspertizat mjekësore, përfshirë këtu ekspertizën e lëmisë së punës, se paditësja si pasojë e aksidentit ka pësuar edhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm punues në shkallë prej 16.75%, për çka edhe me të drejtë i është gjykuar shumata prej 900 euro për periudhën tre mujore deri në arritjen e moshës së pensionimit të paditëses. Ndërsa për ushqimin e përforcuar me të drejtë është bazuar në ekspertizën mjekësore, ku është konstatuar periudha dhe nevoja për ushqim të përforcuar, e cila është gjykuar edhe në përputhje me praktikën gjyqësore. Gjithashtu edhe shumata e gjykuar në emër të dëmit material shërim për terapi fizikale dhe shpenzime të shërimit është gjykuar në bazë të provave materiale (faturat) të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në përputhje me nenin 179 të LMD-së. Si rrjedhojë, Gjykata Supreme vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke refuzuar pjesërisht revizionin e të paditurës, në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale për gjykimin e lartësisë së kërkesëpadisë së paditëses në emër të kompensimit të dëmit jo material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor, si dhe në emër të dëmit material për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm punues, ushqim të përforcuar, ndihmë për kujdes të personit të tretë, për shpenzime të shërimit për terapi fizikale, si dhe shpenzime tjera të mjekimit.

Gjykata Supreme duke marrë për bazë pretendimet në revizionin e të paditurës, por edhe vlerësimin sipas detyrës zyrtare për zbatimin e të drejtës materiale, vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1488/2021, të datës 24.04.2024, në pikën I të dispozitivit, si dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti C.nr.231/2018, datë 21.01.2021, në pikën I, shkronja a) dhe b) e dispozitivit, lidhur me pjesën aprovuese të kërkesëpadisë së paditëses për kompensimin e dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës. Si rrjedhojë, ka rezultuar se shumata e gjykuara nga

gjkata e shkallës së parë dhe të vërtetuara nga gjykata e shkallës së dytë për kompensim të dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike dhe frikës së përjetuar, është e lartë në raport me natyrën e lëndimit, pasojat, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike dhe frikës, të cilat janë përshkruar saktësisht në ekspertizën mjekësore, të përjetuara nga paditësja si pasojë e aksidentit të ndodhur. Shuma e gjykuar për këto kategori të dëmit jo material nuk i përgjigjet natyrës së lëndimit dhe pasojës dhe praktikës gjyqësore për raste të tilla, andaj kjo gjykatë vendosi që në emër të dhimbjeve fizike, e paditura t'ia paguaj paditëses shumën prej 4.500,00 €, si dhe në emër të frikës, t'ia paguaj shumën prej 3.500,00 €. Në lidhje me këtë, është vlerësim i kësaj gjykate se vendosja në këtë mënyrë është vendosje e ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësja, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësen, duke shmangur qëllime tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla, në përputhje me nenin 183 të LMD-së.

Gjykata Supreme i ka vlerësuar edhe pretendimet në revizion lidhur me lartësinë e gjykuar të shpenzimeve të procedurës, mirëpo ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë të pabazuara. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës rezulton se me të drejtë gjykata e shkallës së dytë e ka refuzuar ankesën e të paditurës në lidhje me vendimin për shpenzimet e procedurës, pasi që të njëjtat janë gjykuar nga gjykata e shkallës së parë në përputhje me dispozitën e nenit 452 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, duke marr për bazë edhe suksesin e paditëses në këtë procedurë.

Gjykata Supreme me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet tjera sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 222 të LPK, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.458/2024, datë 27.01.2024

Kryetari i Kolegjit- Gjyqtari

Lumni Sallauka